Affirm® 095 SG

GROUP	6	INSECTICIDE

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Lënda vepruese: Emamectin benzoate

PËRMBAJTJA
Emamectin benzoate : 0,95 %
Lëndë ndihmëse : 99 %

Formulimi: granula të tretshme në ujë (SG).

INSECTICID SPECIFIK, SHUMË EFEKTIV, PËR KONTROLLIN E LEPIDOPTEREVE.

LEVIZ NË MËNYRË TRANSLAMINARE. VEPRON NËPËRMJET KONTAKTIT DHE APARATIT TRETËS. PËRDORET NË PROGRAMET E LUFTËS SË INTEGRUAR (IPM).

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI : SYNGENTA Crop Protection AG, Basel, Switzerland
Tel : +41 61 323 11 11 ; Fax : +41 61 323 12 12

KUJDES



- **Mund të shkaktojë dëmtim të organeve (sistemit nervor) pas ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur.**
- **Shumë toksik për organizmat ujorë, me efekte afatgjata.**

MASA PARAMBROJTËSE

• Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve. •Mos thithni pluhurin. •Mos hani ushqim, pini lëngje ose pini duhan kur përdorni këtë produkt. • Vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit, doreza dhe mjete mbrojtjese personale të frymëmarrjes gjatë përzierjes/ngarkimit dhe gjatë trajtimit. •Në rast të rifutjes në parcelën e trajtuar vishni uniformë mbrojtëse të gjithë trupit dhe doreza. •Hidheni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me legjislacionin kombëtar.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN

•Në përgjithësi: Në rast aksidenti, kërkoni menjëherë këshilla mjekësore dhe i tregoni ambalzhin ose etiketën. Konsultohuni / Vizitoni një mjek nëse nuk ndiheni mirë.
•Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni menjëherë rrobat e ndotura me tretësirën spërkatëse dhe lani mirë pjesët e prekura të trupit me ujë e sapun dhe, më pas shpëlajini me ujë. Nëse acarimi vazhdon, kërkoni këshillë mjekësore.
•Në rast kontakti me sytë: Shpëlajini sytë me ujë të pastër për disa minuta. Konsultohuni me një okulist.
•Në rast gëlltitje: Mos provokoni të vjella. Thërrisni mjekun dhe tregojini ambalazhin ose etiketën.
•Në rast se merret me organet e frymëmarrjes: Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër. Mbajeni të ngrohtë dhe të shtrirë. Thirrni mjekun ose Qendrën e Helmimeve.
ANTIDOTI: Antidot specifik nuk njihet. Ndiqni trajtim simptomatik.

Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.
Mos lani pajisjet spërkatëse pranë ujrave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes sistemit të kullimit.

*Për të mbrojtur organizmat ujorë lini një zonë të patrajtuar mbrojtëse prej **5 metrash** në kulturat perimore me lartësi të ulët (<50 cm), **10 metrash** tek vreshti dhe kulturat e tjera perimore (> 50 cm) dhe **30 metrash** në pemët frutore, nga ujrat sipërfaqësore.*
*Për të mbrojtur kulturat jo objekt lini një zonë të patrajtuar mbrojtëse prej **10 metrash** nga pjeshka, nektarina dhe molla.*

***I rrezikshëm për bletët**. Për të mbrojtur bletët dhe insektet e tjera pjalmuese mos e përdorni produktin gjatë të lulëzimit të kulturave bujqësore dhe të barërave të këqija. Hiqni ose/dhe shkatërroni barërat e këqija përpara se të lulëzojnë. Mos e përdorni produktin gjatë periudhës kur bletët po mbledhin pjalmë. "Pas trajtimit, bletët duhet të qëndrojnë në kosheret e tyre për një ditë duke u siguruar ushqim dhe ujë brenda kosheres ose kosheret duhet të hiqen. Trajtimi duhet të kryhet pas përfundimit të fluturimit të bletëve, në orët e vona të pasdites".*

Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.

Kategoria dhe mënyra e veprimit: Insekticid jo-sistemik për kontrollin e lepidoptereve që prekin perimet, luleshtrydhen, hardhinë, agrumet, mollën, pjeshkën dhe kulturat e tjera. Paraqet lëvizje translaminare. Vepron kryesisht me gëlltitje. Lënda vepruese,Emamectin benzoate, lidhet me receptorët e acidit γ-aminobutirik (GABA) dhe aktivizon kanalin e joneve të klorit, duke shkaktuar hapjen e zgjatur të këtyre kanaleve. Nga fluksi i vazhdueshëm i joneve të klorit në indet e muskujve, pengohet tkurrja e muskujve, që çon në paralizë dhe pastaj në vdekjen e insekteve.

PËRDORIMI:

Kulturat bujqësore	**Dëmtuesit**	**Doza (gr/100 l ujë)**	**Vërejtje**
DOMATE -në fushë të hapur **DOMATE** -në serra	***Tuta absoluta*** ***Tuta absoluta***	150	Sasia e tretësirës spërkatëse varet nga faza e zhvillimit të bimëve, 300 – 1500 l/ ha. Numri maksimal i trajtimeve për çdo sezon kultivimi: 3. Interval i trajtimeve: 7 - 14 ditë. Të përdoret në programe trajtimesh duke e alternuar me insekticide që kanë mënyra të ndryshme veprimi.
PERIME **(Spec F+S, Patlixhan F+S, Kastravec S, Pjepër F+S, Shalqi F+S, Kungull S, Marule F, Lakër F, Lulelakër F, Fasule të njoma F, Brokoli F, Angjinare F, Karotë F, Luleshtrydhe**	***Tuta absoluta,*** ***Heliothis armigera,*** ***Spodoptera spp.,*** ***Ostrinia nubilalis,*** ***Plusia gamma,*** ***Pieris brassicae,*** ***Plutella xylostella,*** ***Depressaria erinaceella etj.***		
MOLLË **DARDHË**	***Cydia pomonella,*** ***Cydia molesta,*** ***Adoxophyes spp.,*** ***Pandemis spp.,*** ***Archips sppp.,*** ***Argyrotaenia spp.*** ***Minatriçet e gjetheve:*** ***(Leucoptera spp.,*** ***Phyllonoricter spp.)***	300	Trajtimet fillojnë me shfaqjen e larvave të para. Numri maksimal i trajtimeve (nqs nevojiten) për çdo sezon kultivimi: 2. Interval i trajtimeve: 7-14 ditë.
AGRUME **(Portokalli, Mandarina, Klementinë, Limon)**	***Phyllocnistis citrella***	100-200	Trajtimet fillojnë me shfaqjen e larvave të para. Numri maksimal i trajtimeve (nqs nevojiten) për çdo sezon kultivimi: 2. Interval i trajtimeve: 14 ditë.

HARDHI	***Lobesia botrana,*** ***Clysia ambiguella,***	150	Trajtimet fillojnë me shfaqjen e larvave të para. Numri maksimal i trajtimeve (nqs nevojiten) për çdo sezon kultivimi: 3. Interval i trajtimeve: 7-14 ditë.
PJESHKË **NEKTARINË** **KAJSI**	***Cydia molesta,*** ***Anarsia lineatella***	300	
KUMBULL	***Cydia funebrana***	300	Trajtimet fillojnë me shfaqjen e larvave të para. Numri maksimal i trajtimeve (nqs nevojiten) për çdo sezon kultivimi: 3. Interval i trajtimeve: 7 ditë.
LULE **BIMË ZBUKURUESE**	***Epichoristoides acerbella,*** ***Heliothis armigera,*** ***Spodoptera spp.,*** ***Ostrinia nubilalis,*** ***Plusia gamma,*** ***Pieris brassicae,*** ***Plutella xylostella,*** ***Depressaria erinaceella*** ***Tuta absoluta,***	150	

Mënyra e përdorimit : Me spërkatje, gjatë së cilës duhet të sigurohet lagie e mirë e bimëve.

Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit duke vazhduar përzierjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.

Koha e trajtimit : Me shfaqjen e shënjave të para të infeksionit.

Karenca: Luleshtrydhe, Angjinare 1 ditë, Perime 3 ditë, Mollë, Dardhë, Hardhi, Agrume, Pjeshkë, Nektarin, Kumbull 7 ditë, Kajsi 14 ditë .

Fitotoksiciteti: Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme.

Përzihet me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes. Në rastin e përzierjes me formulime të tjera, bëni paraprakisht testin e pajtueshmërisë.

Menaxhimi i rezistencës: Produkti përmban lëndën vepruese emamectin benzoate, që i takon grupit 6 sipas IRAC. Për të zvogëluar rrezikun e zhvillimit të rezistencës, rekomandohen sa më poshtë:

- Përdorimi i teknikave të kultivimit dhe metodave fizike dhe biologjike për të kufizuar popullatën e insekteve dhe për të zvogëluar numrin e trajtimëve në ato absolutisht të nevojshme për kontroll efektiv.
- Trajtime, vetëm kur është e nevojshme, bazuar në pragjet e dëmit ekonomik (nëse ka) dhe në një mënyrë që minimizon rrezikun për artropodët e dobishëm.
- AFFIRM 0.95 SG duhet të aplikohet në kohën e duhur, duke synuar fazat më të ndjeshme biologjike të insekteve dëmtues.
- Produkti duhet të përdoret në dozat dhe intervalet e rekomanduara dhe në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulim të mirë dhe uniform të sipërfaqes gjethore me tretësirën spërkatëse.
- Shmangni trajtimet e njëpasnjëshme me AFFIRM 0.95 SG. Produkti duhet të përdoret në alternim me insekticide me mënyra të tjera veprimi.
- Të kryhet kontroll sistematik i popullatave të dëmtueve për të identifikuar zhvillimin e hershëm potencial të rezistencës. Nëse gjenden raste të reduktimit të efektivitetit, trajtimet e tjera duhet të bëhen me preparate të një grupi tjetër.

Periudha e ruajtjes: 2 vjet.

Udhëzime për tërheqjen e sigurt të produktit dhe paketimit: Shishet bosh të ambalazhit shpëlahen me ujë nën presion ose shpëlahen tre herë (uji i shpëlarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimi: Preparati ruhet në shishe të mbyllura, në vende të thata e të freskëta. Evitoni ruajtjen në temperatura nën -10^0 C dhe mbi 35^0 C.

